



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Përmbledhje mujore e aktiviteteve nga IPK – Qershor 2026

Menaxhimi i ankesave

IPK gjatë muajit Qershor 2026 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 248 ankesa. Prej tyre 177 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës në Policinë e Kosovës, disa janë përcjellë në institucione tjera kurse 65 nga to janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve në IPK më dyshimin për veprimtari penale.

	Gjithsej	Për javë	Për ditë
Numri i ankesave	248	62	8.2

Aktivitete në fushën e hetimeve

Bazuar në mandatin e paraparë me legjislacionin në fuqi, IPK kryen hetime penale dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë. Gjatë muajit Qershor 2026 Departamenti i Hetimeve në IPK ka pranuar 65 raste për hetim penal dhe në kuadër të autorizimeve ligjore ka dhënë rekomandimin për suspendim në interes të hetimit për 12 punonjës të Policisë së Kosovës.

Aktivitetet e këtij Departamenti janë shprehur në mënyrë tabelore si në vijim:

Indikatori (numri)	Të dhëna për muajin Qershor 2026
Kallëzime penale të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	4
Raporte të veçanta të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	4
Raporte informuese të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	9
Raste të proceduara në DHB, DPP-PK dhe Arkiv-IPK	31
Rekomandime për suspendim	12
Të arrestuar	0

Aktivitete në fushën e inspektimit

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese. Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore përmes inspektimeve.

Gjatë muajit Qershor 2026 inspektorët e IPK-së kanë qenë të angazhuar në këto inspektime:

Fusha e inspektimit	Lloji	Statusi
Menaxhimi i Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor të Rahovecit	Jashtëzakonshëm	Në proces
Kompensimet për orët jashtë orarit të rregullt të punës	Jashtëzakonshëm	Në proces
Vlerësimi i performancës së stacioneve policore	I rregullt	Në proces